



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Durrës, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[07/08/2023]

Drejtuar: **POWER INDUSTRIES** me NIPT L51706022H me adrese Tiranë, Vorë, Picar, Zona Kadastrale Nr.3974.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, Mall

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-58081-02-06-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës Blerje Kazane per mbetje urbane

Afati për zbatimin e saj: 90 ditë

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Data 27 mars 2023 Numri: 28

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. LEON KONSTRUKSION me NIPT K71820009I me vlerë të ofertës 22'750'000 (njetzet e dy million e shtateqind e pesedhjetë mijë) lekë
2. ZEQRIRI me NIPT J67902827A me vlerë të ofertës 26'397'000 (njetzet e gjashtë million e treqind e nentedhjetë e shtatë mijë) lekë
3. POWER INDUSTRIES me NIPT L51706022H me vlerë të ofertës 28'980'000 (njetzet e tete million e nenteqind e tetedhjetë mijë) lekë
4. VIBTIS me NIPT L02103503S me vlerë të ofertës 29'620'500 (njetzet e nente million e gjashtëqind e njetzet mijë e peseqind) lekë

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1- Për ofertuesin **LEON KONSTRUKSION me NIPT K71820009I**, me vlerë të ofertës **22'750'000 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **LEON KONSTRUKSION**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet “*Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 11 '900 '000 lekë*”, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, KVO e konsideron të papërmbushur, për arsyet si më poshtë vijojne:

- Kontrata me objekt “*Permiresimi dhe rinovimi i sistemit të muzeve të qytetit të Gjirokastrës*”, me Autoritet Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pas analizimit të zerave të preventivit, nuk konsiderohet punë e ngjashme me objektin e prokurimit.

- Operatori ekonomik ka lidhur edhe Marreveshjen Kuader me objekt “*Loti 4 – Blerje materiale mobilimi urban sipas kërkesave të Bashkive*”, date 15.08.2022, me Autoritet Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me afat 24 muaj. Referuar kontratave të lidhura në respektim të marreveshjes kuader se sipercituar, si edhe faturave perkatëse të paraqitura, totali i zerave të konsideruara punë e ngjashme, nuk e arrin vlerën minimale të kërkuar.

2. Nuk përmbush piken 2.3.gj të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Ne mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi, për të gjitha zerat objekt prokurimi në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen*”, pasi referuar katalogut të paraqitur, konstatohet që të dhënat e mallit të ofruar nuk janë konform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK.

- Për ofertuesin **ZEQIRI me NIPT J67902827A**, me vlerë të ofertës **26'397'000 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, rivlereson ofertën në respektim të Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe Komisionit të Prokurimit Publik nr. 294/2023, me nr. 619/8 prot., date 25.04.2023, si më poshtë:

1. Çertifikata standarti EN 840-2-5-6 (standart nderkombetar) nuk përmban objektin e prokurimit i cili është kriteri i kërkuar në pikën 2.3d të kapacitetit teknik. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Zeqiri”.

2. Nuk plotëson Specifikimet teknike: Kazane plastik për mbetje urbane me kapacitet 1100 Litra.

- Përmasat e kontenierit: Lartësia: 1340-1360 mm, Trashësia Thellessia: 1050-1080 mm, Gjerësia: 1350-1380 mm.

- Trupi i kontenierit të ndërtohet nga material plastik (HDPE), jo i demshëm nga rrezet UV, dhe rezistent ndaj temperaturave të ulta (deri në -30°C) dhe të larta (deri në +80°C).

- Kontenieri të jete në gjendje të duroje kushtet klimaterike të ndryshme, për të gjithë përberësit, dhe temperatura nga -20°C deri +50° C.

- Kontenieri të jete në përputhje me standartin RAL GZ 951/1 dhe AfPS GS2019” u konstatua se katalogu i paraqitur, me të dhënat e mallit të ofruar nuk janë konform specifikimeve teknike të mallit të kërkuar nga AK. Ky kriter nuk plotësohet nga operatori ekonomik “Zeqiri”.

3. Nuk plotëson kriterin për pikat: 2.3.b. “*Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e*

cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme”; 2.3.c. *“Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme*”, pasi të dyja ISO-t e kërkuara nuk përmbajnë objektin e prokurimit.

- Për ofertuesin **VIBTIS me NIPT L02103503S**, me vlerë të ofertës **29’620’500 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **VIBTIS**:

1. Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes se kerkuar ne DST.
2. Nuk ka paraqitur certifikaten ISO 9001 te prodhuesit, sic eshte kerkuar ne specifikimet teknike.
3. Nuk permbush piken 2.2.b te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, ku citohet se *“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”*, pasi nuk ka paraqitur asnje nga bilancet e kërkuara.
4. Nuk permbush piken 2.3.d te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Çertifikate standarti EN 840-2-5-6 te mallit objekt prokurimi”*, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.
5. Nuk permbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Çertifikate standarti RAL GZ951/1 te mallit objekt prokurimi”*, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.
6. Nuk permbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese dokumentacion i cili verteton qe malli objekt prokurimi eshte ne perputhje me standartin CE”*, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.
7. Nuk permbush piken 2.3.g te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim te prodhuesit/distributorit te autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast se do te paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik duhet ta vertetoj kete duke paraqitur akt-marreveshje/autorizim/kontrate lidhur mes kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar”*, pasi fragmenti i katalogut te paraqitur eshte ne gjuhen angleze.
8. Nuk permbush piken 2.3.h te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me standartet e kerkuara operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion justifikues (certifikata/deklarata prodhuesi) per standartet dhe kerkesat qe duhet te permbushin zerat e kerkuara ne formularin e specifikimeve teknike”*, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.
9. Nuk permbush piken 2.3.h te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për të gjithë zerrat objekt prokurimi...”*, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.
10. Nuk permbush piken 2.3.j te Kapacitetit Teknik, ku citohet se *“Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë*

shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore”, pasi nuk ka paraqitur asnje deklaratë në përmbushje të këtij kriteri.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë informojmë [POWER INDUSTRIES me adresë Tiranë, Vorë, Picar, Zona Kadastrale Nr.3974.], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: 28’980’000 (njezet e tete million e nenteqind e tetedhjetë mijë) lekë /pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Durrës, Njësia e Prokurimit, *njesia.prokurimeve@durres.gov.al*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguria e ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [NUK KA TE KLASIFIKUAR TJETER PERVEC KETIJ OPERATORI], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO X JO

Nëse Po: (Vendim i KPP me Nr.657/2023 datë 24/07/2023)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Emiriana Sako